



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr.33
Prishtinë, më 7.05.2010, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Petar Miletić, Sanije Aliaj, Enis Kervan, Mursel Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Hafize Hajdini, Müfera Şinik dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Dragiša Mirić dhe Zafir Berisha.

Pjesëmarrës të tjerë: monitorues nga Zyra e Presidentit, OSCE-së, KDI – së.

Nga Stafi Mbështetës: Vilson Ukaj dhe Dashurie Canolli.

Mbledhjen e kryesoi: Petar Miletić, Kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Dhënia e informatave nga Bordi i RTK-së lidhur me implementimin Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës,
I ftuar: Rrahman Paçarizi, Kryetar i Bordit të RTK-së;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente;
5. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
6. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi pasi që nuk iu ka përgjigjur ftesës kryetari i bordit të RTK-së pas asnjë arsyetim, propozoi që pika e dytë të shtyhet për në mbledhjen e radhës. Do ti dërgohet një shkresë proteste kryetarit të bordit të RTK-së në emër të komisionit.

Rendi i ditës u miratua me ndryshime. Pika e dytë shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit. Në vazhdim bëhet rirenditja e pikave të rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion, me amendamente

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët tjerë të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente

Kryesuesi kërkoi nga anëtarët të deklarohen lidhur me projektligjin në fjalë dhe amendamentet e propozuara, nëse mendojnë se ato cenojnë apo shkelin të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

Pasi që nuk kishte vërejtje, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë dhe raportin me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, dhe ka konstatuar nuk cenojnë dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve, dhe i rekomandon Kuvendit miratimin e projektligjit me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, me raportin e komisionit funksional - Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Enis Kervan njoftoi se si grup parlamentar i kemi dërguar një propozimamendament komisionit funksional, i cili është radhitur si pika e amendamentit 1. Kërkoj që ky komision të rekomandojë komisionit funksional, që me rastin e dërgimit të raportit për projektligjin në seancë plenare për miratim, ky amendament të ndahet si i veçantë.

Sadik Idriz njoftoi se komisioni ka diskutuar këtë çështje dhe në praninë e përfaqësuesve të kryqit të kuq ka mësuar se nuk mundet që ligji të ketë dy emra kryqi kuq dhe gjysmëhëna e kuqe sepse në këtë formë me dy emra dhe sheja nuk mund të regjistrohet në organizatën ndërkombëtare të kryqit të kuq në Gjenevë. Komisioni ka shqyrtuar dhe nuk ka përkrahur amendamentin e propozuar nga deputeti Riza Smaka dhe amendamentin e propozuar nga grupi 7+. Kërkesa është që ky komision të kërkojë nga komisioni funksional që të ndahet propozimamendament i grupit 7+, si i veçantë në seancë plenare.

Zylfi Merxha mbështeti propozimet e z. Kervan dhe z. Idriz që lidhur me amendamentin e grupit 7+ që të ndahet si i veçantë.

Numan Balic propozoi që komisioni të del me një propozim amendament ku kërkohet që titulli i ligjit të jetë Ligji për Kryqin e kuq dhe Gjysmëhënën e kuqe.

Kryesuesi mbështeti propozimin e z. Balic që komisioni të del me një amendament që në titullin e projektligjit dhe në tërë tekstin e tij të thuhet Ligji për Kryqin e kuq dhe Gjysmëhënën e kuqe.

Enis Kervan theksoi se për dallim nga pika a dhe b e amendamentit 1 ku thuhet se ndryshimi duhet të bëhet vetëm në titull, pika c e propozuar nga grupi 7+, kërkon që ndryshimi të bëhet në titull dhe në tërë tekstin e projektligjit. Prandaj edhe kërkojmë që kjo pikë të ndahet si e veçantë.

Xhevdet Neziraj theksoi se ndihet keq që nuk iu është bordi i RTK-së nuk iu ka përgjigjur ftesës së komisionit për këtë takim, që tregon edhe njëherë se po nënvlerësohet puna e këtij komisioni dhe kërkoj që në emër të komisionit të kërkohet sqarime për mospërgjigjen e ftesës. Sa i përket çështje së amendamentin 1 të komisionit funksional lidhur me projektligjin për kryqin e kuq, mbështeti propozimin e deputetit Smaka dhe kërkoj që të jetë Ligji për Kryqin e kuq dhe Gjysmëhënën e kuqe. Nëse ka problem në regjistrim, ato mund të regjistrohen si dy organizata të veçanta.

Sadik Idriz theksoi se përfaqësuesit e kryqit të kuq na kanë njoftuar, se nuk mund të regjistrohet si organizatë nacionale me dy emra.

Mufera Sinik kërkoj që komisioni të jep amendamentin e vet dhe të kërkohet që propozimi amendamenti i grupit 7+ të jetë i veçantë dhe komisioni funksional ta rregullojë çështjen e dërgimit në seancë.

Numan Balic kërkoj që komisioni të del me amendamentin e vet dhe grupi 7+ me amendamentin të veçantë.

Pasi vërejtjeve dhe propozimeve, Kryesuesi konstatoi se Komisioni me tetë vota PËR (Petar Miletić, Sanije Aliaj, Mursel Haljilji, Numan Balić, Zylfi Merxha, Hetem Arifi, Sadik Idriz, Hafize Hajdini dhe Xhevdet Neziraj, një ABSTENIM (Mufera Sinik) dhe një KUNDËR (Enis Kervan) nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për Kryqin e Kuq të Kosovës me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Kryqin e Kuq të Kosovës, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara, me përjashtim të amendamentit 1.

Vërejtje konkrete

Amendamenti 1

Amendamenti i propozuar nga grupi parlamentar 7+ i radhitur si pika c me rastin e hartimit të raportit për miratimin e projektligjit për seancë plenare të shkojë si i veqnat.

Në titullin e projektligjit shtohet teksti si në vijim:

“Gjysmëhënën e Kuqe të Republikës së Kosovës”

(ky ndryshim bëhet në tërë tekstin e projektligjit)

5. Shqyrtimi i Projektligjit për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve, me raportin e komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente

Kryesuesi propozoi që edhe në këtë projektligji të propozohet amendamenti ku do të thuhet se në titullin dhe në tërë tekstin e projektligjit bëhet ndryshimi si në vijim për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq dhe gjysmëhënës së kuqe, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve.

Pasi propozimit, Kryesuesi konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

- I. Komisioni ka shqyrtuar Projektligjin për përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës të kryqit të kuq, emblemave të tjera dalluese dhe sinjaleve me amendamente të komisionit funksional – Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, dhe ka konstatuar se dispozitat e tij nuk cenojnë të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara, me përjashtim të amendamentit 1.

Vërejtje konkrete

Amendamenti 1

Në titullin e projektligjit pas tekstit “emblemës të kryqit të kuq” shtohet teksti si në vijim:

“dhe emblemës së gjysmëhënës së kuqe”

(ky ndryshim bëhet në tërë tekstin e projektligjit)

6. Të ndryshme

Kryesuesi theksoi ky komisioni qëndron prapa propozimit të tij për plotësimin e nenit 10 të projektligjit për shërbimin civil.

Numan Balic kërkoi që të përsëritet ftesa për bordin e RTK-së që të vijë urgjent në mbledhjen e këtij komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

E përqatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Petar Miletić